Argumentimi: Përcaktimi i numrit të punonjësve bazohet tek Ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore dhe tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës etj.. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje : prill, maj, qershor 2026 tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës.

Numri i punonjësve të kërkuar është vendosur minimalisht : 20 persona sipas kriterëve më sipër:

1 Inxhinier Elektrik (drejtues teknik në licencën e shoqërisë)+ 1 Inxhinier Mekanik (drejtues teknik në licencën e shoqërisë) + 2 Inxhinierë Elektrik me profil Automatizimi industrie, ku të paktën njëri prej tyre të jetë certifikuar për: Softëare programimi PLC dhe SCADA; Licencë

R. Rrezhda

Th. Koroveshi

Projektues Instalator kategoria 4.g; Specialist për invertera ; +1 Inxhinier i çertifikuar: Profesionist Rrjeti Ndermarrje i Sigurisë Kibernetike; Specialist Ndermarrjeje i Sigurisë Kibernetike ; + 1 Inxhinier Elektronik + 1 Inxhinier Mekanik + 4 Specialistë Elektricitë+ 2 Montator+ 1 shofer kamioni vinç+ 1 Manovrator minieskavatori+ 5 punëtorë krah = 20.

Periudha kohore e listpagesave të sigurimeve shoqërore është përcaktuar periudha : prill, maj, qershor 2026 , në mënyrë që kriteri të përfshijë një periudhë sa më koherente.

Vlerësohet domosdoshmëria e stafit të punësuar për një periudhë të mëparshme, periudhën: prill, maj, qershor 2026 duke argumentuar se kjo shërben si tregues i një marrëdhënie të besueshme e të qëndrueshme midis punëdhënësit e punëmarrësit.

2.2.7 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:

Nr.	Lloji i Makinerive / Pajisjeve	Statusi	Sasia
1	Autovinc min 10 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Automjet teknik për transport pajisjesh dhe ekupeve në terren	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Kamera inspektimi termografike	në pronësi ose me qira	Copë 1
5	Testues për instalime (Multifunksional Installation Tester) Përfshirë RCB	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Laptop ose stacion programim	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Licenca për software dhe programim të pajisjeve (SCADA, HMI, PLC)	në pronësi ose me qira	Copë 1
8	Insulation Tester (Meger) deri 5000 V me certificate kalibrimi	në pronësi ose me qira	Copë 1
9	Kalibruer 4-20mA	në pronësi ose me qira	Copë 1

R. Rrezhda

Th. Koroveshi

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronesinë e mjetit: -leja e qarkullimit; -çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin dhe fotot perkatese;
- Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plote të punimeve.
- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesiperm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plote të punimeve.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë, në çdo kohë, deri në përfundimin e kontratës mjetet dhe pajisjet teknike të deklaruara nga operatori ekonomik.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve dhe pajisjeve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar për këtë pike.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Lloji dhe sasia e makinerive të kërkuara është përcaktuar në raport (në përpjestim) me punimet konkrete që do të kryhen, volumet e tyre dhe grafikun e punimeve.

Testuesi i izolacionit dhe kalibruesi 4-20mA përbëjnë pajisje të rëndësishme për realizimin e punimeve të parashikuara. Kjo siguron përputhshmëri me standardet teknike për vënien në punë të linjave kabllorë elektrike dhe sistemeve të kontrollit, të cilat nuk mund të kryhen pa disponimin e këtyre pajisjeve.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor apo nënligjor, në bazë të të cilit është bërë përlllogaritja teknike e numrit të punonjësve dhe mjetet/makineritë/pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës)

R. Rrezhda

Th. Koroveshi

2.2.8 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizma ndërkombëtarë akreditues, **ose Certifikata ekuivalente të njohura nga organizmi kombëtar i akreditimit i njohur nga Republika e Shqipërisë**, si më poshtë:

- ISO 9001:2015 – Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent
- ISO 14001:2015 – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor ose ekuivalent
- ISO 45001:2018 – Sistemet e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ose ekuivalent
- ISO/IEC 27001:2022 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit dhe Sigurisë Kibernetike ose ekuivalent

Shënim: Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet të plotësojë kriterin në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjen dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Certifikatë për Sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001 (e vlefshme) për të garantuar kërkesat cilësore të materialeve të ndërtimit dhe punimeve të zbatimit.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Certifikatë për Sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001 (e vlefshme) për të garantuar rehabilitimin e plotë të sheshit të ndërtimit gjatë dhe pas kryerjes së punimeve me ndikime sa më të vogla në mjedis.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Certifikatë për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë ISO 45001-2018 për të garantuar sigurinë e punëtorëve të zbatimit gjatë kryerjes së punimeve.

Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO/IEC 27001:2022 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit dhe Sigurisë Kibernetike ose Çertifikatën ekuivalente të njohur nga organizmi kombëtar i akreditimit i njohur nga Republika e Shqipërisë për të siguruar menaxhimin e sigurisë të informacionit e cilësisë të punëve që kërkohen dhe lidhen me sistemet e teknologjisë së informacionit. Ky lloj çertifikimi siguron që OE ka të implementuar një sistem menaxhimi të Sigurisë së Informacionit dhe Sigurisë Kibernetike për punën e ofruar. Nevojitet që siguria kibernetike e sistemit, modemmat shpërndaesat e internetit mos kenë ndërhyrje të jashtme të cilat mund të çojnë në çorjentimin e sistemit SCADA.

2.2.9 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar për pajisjet/mallrat transformatorë, fidër, invertera, SCADA, elektropompa dhe valvulat pjesë e objektit të prokurimit.

Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori, OE duhet të paraqesë:

dokumentacion për të vërtetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar, pra për të vërtetuar se subjekti në fjalë është distributor zyrtar .

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme kjo për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm që garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të pajisjeve/mallrave: transformatorë, fidër, invertera, SCADA, elektropompa dhe valvulat. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të pajisjeve/mallrave: që kërkohen , që janë prodhuar në përputhje me standarde të përshtatshme cilësie. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës, lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues për aftësitë teknike dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 39 të VKM- së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , të ndryshuar.

2.2.10 Për të dëshmuar se i plotësojnë kërkesat teknike të përcaktuara në DT , operatorët ekonomikë duhet të paraqesin katalogë /skede teknike, për pajisjet/mallrat: transformatorë, fidër, invertera, SCADA, elektropompa dhe valvulat që janë pjesë e objektit të prokurimit, ku të tregohen qartë se karakteristikat teknike të pajisjeve/materialeve, janë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Në katalogun/et/skeda të paraqitura të shënohen në mënyrë të dukshme modeli i pajisjes/mallrave të ofruar, së bashku me specifikimet teknike të kërkuara nga AK.

Pjesët specifike të katalogut/skedës teknike, ku jepen karakteristikat teknike nqs nuk janë në gjuhën shqipe të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga ana e AK në zbatim të kërkesave që përcakton ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” me ndryshime, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” me ndryshime.

Plotësimi i këtij kriteri garanton ekzekutimin e objektit të kontratës në përputhje me specifikimet teknike të DT.

R. Rrezhda

Th. Koroveshi

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdokërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

- Operatori ekonomik që do të kryejë ekzekutimin e punëve duhet të paraqesë:

- çertifikatat e prodhuesit e markimit CE/SSH për pajisjet/mallra : transformatorë, fidër, invertera, SCADA, elektropompa dhe valvulat , që vërtetojnë përputhjen me specifikimet teknike të kërkuara, si dhe vërtetojnë se prodhuesi i këtyre pajisjeve/mallrave është në përputhje me kërkesat e sigurisë sipas standardeve Europiane dhe Shqiptare, standarde këto të përcaktuara në specifikimet teknike.
- Fletë garanci me afat minimal 2 vjet për pajisjet/mallrat: transformatorë, invertera, elektropompa, SCADA dhe pajisjet e saj.
- Manualët e përdorimit të pajisjeve/mallrave në gjuhë angleze.
- Garancia e punimeve: 2 vjet.

Bashkangjitur paraqitet Projekti i zbatimit.

Bashkangjitur paraqitet Preventivi i punimeve.

Bashkangjitur paraqiten specifikimet teknike për zbatimin e projektit.

Bashkangjitur paraqitet Grafikut i zbatimit të punimeve.

R. Rrezhda

Th. Koroveshi

Së pari: Tek Dokumentat teknike , që i bashkangjiten Shtojcës 5 të DT, konkretisht tek:

- Specifikimet teknike të materialeve elektrike, mekanike dhe hidraulike: 40 faqe.
- Preventivi i punimeve: 6 faqe,

çdo standard europian i kërkuar :

“IEC 61439 ; IEC 60204 ; IEC 60183; IEC 60287 ; IEC 60502-2 ; IEC 60230 ; IEC 60332; IEC 62271-100; IEC 62271-102; IEC 62271-200; IEC 60076; IEC 60076-11; IEC 60068-2-6; IEC 60068-2-27; IEC 61000-4-2; IEC 61000-4-3; IEC 61000-4-4; IEC 61000-4-5; IEC 61000-4-6; IEC 60228; IEC 60044-1/2; IEC 62053-22; IEC 61850-3; IEC 61439-1/-2; IEC 62053-23 ; IEC 61158;; IEC 62443; IEC 62351; IEC 61000-6-2 IEC 61000-6-4 ; IEC 62040-5-3 ; IEC 60664-1; IEC 62262; IEC60664;IEC 60364-5-54; IEC 60947-4-1; IEC 60947-7-1; IEC60445; IEC60446; IEC60529;IEC 61082-1; IEC 61346-2; IEC 61131-2; IEC61346;IEC60204-1.”, shoqërohet me fjalët :

“ose sipas standardit SSH/IEC/ISO ekuivalente të këtij standardi, të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Standardet e referencës janë ato vendeve të Bashkimit Europian IEC dhe standardet shqiptare që konsiderohen si ekuivalente.”

Argumentim: Sipas pëcaktimit të nenit 36 të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020, pika 3/b i ndryshuar, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e AK, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve.

Krahas standarteve europiane: “IEC 61439 ; IEC 60204 ; IEC 60183; IEC 60287 ; IEC 60502-2 ; IEC 60230 ; IEC 60332; IEC 62271-100; IEC 62271-102; IEC 62271-200; IEC 60076; IEC 60076-11; IEC 60068-2-6; IEC 60068-2-27; IEC 61000-4-2; IEC 61000-4-3; IEC 61000-4-4; IEC 61000-4-5; IEC 61000-4-6; IEC 60228; IEC 60044-1/2; IEC 62053-22; IEC 61850-3; IEC 61439-1/-2; IEC 62053-23 ; IEC 61158;; IEC 62443; IEC 62351; IEC 61000-6-2 IEC 61000-6-4 ; IEC 62040-5-3 ; IEC 60664-1; IEC 62262; IEC60664;IEC 60364-5-54; IEC 60947-4-1; IEC 60947-7-1; IEC60445; IEC60446; IEC60529;IEC 61082-1; IEC 61346-2;IEC 61131-2; IEC61346;IEC60204-1.”, AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/IEC, mbi konformitetin e standardit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë, për shkak të ekzistencës të standardeve ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit.

R. Rrezhda

Th. Koroveshi

Së dyti: sqarojmë se:

Paisjet duhet të ofertohen me vlerën e tyre të plotë përfshirë vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), vlera totale e tyre e paisjeve (bashkë me TVSH) duhet t'i shtohen në përfundim totalit të propozuar të ofertës ekonomike pa TVSH.

Në përllogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike pa TVSH në këtë rast, ku krahas ndërtimit/rinovimit ka edhe paisje, vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH do të jetë vlera e punimeve të kërkuar pa TVSH, shtuar vlerën e fondit rezervë, shtuar vlerën e paisjeve (të cilat ofertohen së bashku me TVSH), ndërsa vlera totale e ofertës ekonomike me TVSH, përfshin njëherazi edhe 20 % e vlerës pa TVSH të punimeve, duke shmangur paraqitjen gabim të vlerës së ofertës pa TVSH, duke përfshirë TVSH për “Makinëri e pajisje” dy herë.

Së treti: Në dokumentin “Specifikimet.pdf”, “Specifikime teknike të materialeve elektrike, mekanike dhe hidraulike”, (faqet 11-16 të dokumentit) , janë shtuar **specifikimet teknike për VFD 350 kW, sipas dokumentit bashkangjitur.**

Së katërti: Në dokumentin “Specifikimet.pdf”, janë shtuar **specifikimet teknike në lidhje me PLC-të dhe HMI-të, si dhe vizatimet, I/O, sipas dokumentit bashkangjitur.**

Së pesti:

Lidhur me mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera specifikojmë që autoriteti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, **për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, konkretisht ndalohet mbështetja për:**

2.2.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme

2.2.2 Disponimi i Licencës profesionale të Operatorit Ekonomik

2.2.3 Personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë.

2.2.4 Staf mbështetës

2.2.7 Mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës

2.2.8 Certifikatat të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit (ISO)

Argumentim : Kërkojmë që vetë OE ose BOE dhe jo subjekte mbështetese, të përmbushin kërkesat si me poshte

2.2.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme.

R. Rrezhda

Th. Koroveshi

Autoriteti Kontraktor vlerëson se përvoja e suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme përbën një element thelbësor dhe kritik për zbatimin e kontratës. Objekti i prokurimit lidhet me rikonstruksionin e një stacioni pompimi, i cili përfshin punime të specializuara mekanike dhe elektrike, të ndërlidhura me funksionimin e pandërprerë dhe të sigurt të sistemit.

Për shkak të natyrës teknike dhe rëndësisë së veçantë të punimeve, kërkohet që operatori ekonomik ofertues të ketë realizuar vetë kontrata të ngjashme dhe të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera për përmbushjen e këtij kriteri. Kjo kërkesë synon të garantojë se operatori që do të zbatojë kontratën disponon drejtpërdrejt përvojën, ekspertizën organizative dhe kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin me sukses të punimeve.

2.2.2 Disponimi i Licences profesionale te OE.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik ofertues të disponojë licencën profesionale përkatëse për realizimin e punimeve objekt prokurimi. Në rastin e ofertimit nga një bashkim operatorësh ekonomikë, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur kur licenca disponohet nga të paktën një prej anëtarëve të bashkimit që do të jetë i angazhuar në realizimin e punimeve për të cilat kërkohet licenca.

Kjo kërkesë vendoset për të garantuar që gjatë zbatimit të kontratës të ekzistojë kapaciteti i nevojshëm profesional dhe autorizimi ligjor për kryerjen e punimeve objekt prokurimi. Duke qenë se objekti i kontratës lidhet me rikonstruksionin e stacionit të pompimit dhe përfshin punime që kërkojnë licencim sipas legjislacionit në fuqi, disponimi i licencës nga operatori ekonomik ose nga një prej anëtarëve të bashkimit siguron përmbushjen e kërkesave ligjore dhe teknike për realizimin e kontratës.

2.2.3 Personelin kryesor , drejtues teknik ne licencen e shoqerise

Argumentim: Autoriteti Kontraktor kërkon disponimin e personelit kryesor, drejtuesit teknik të pasqyruar në licencën profesionale të shoqërisë, në funksion të garantimit të realizimit të punimeve sipas kërkesave të projektit, specifikimeve teknike dhe standardeve në fuqi.

Objekti i prokurimit përfshin rikonstruksionin e stacionit të pompimit, punime të cilat kërkojnë organizim, drejtim dhe mbikëqyrje teknike të specializuar gjatë gjithë fazës së zbatimit të kontratës. Për këtë arsye, drejtuesi teknik përbën një element thelbësor të kapacitetit profesional të operatorit ekonomik dhe garanton zbatimin korrekt të punimeve, kontrollin e cilësisë dhe respektimin e kërkesave teknike të kontratës.

Kriteri është në raport të drejtë dhe proporcional me natyrën, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e operatorit ekonomik për realizimin me sukses të objektit të prokurimit.

2.2.4 – Stafi mbështetës

Argumentimi :Autoriteti Kontraktor kërkon disponimin e stafit mbështetës të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt prokurimi, duke vlerësuar natyrën dhe kompleksitetin e punimeve që do të kryhen në kuadër të rikonstruksionit të stacionit të pompimit.

Stafi mbështetës luan rol të rëndësishëm në organizimin, koordinimin, ndjekjen dhe realizimin e proceseve të punës në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe afatet kontraktuale. Disponimi i këtij personeli garanton kapacitetin teknik dhe organizativ të nevojshëm për përmbushjen e kontratës sipas standardeve të kërkuara.

R. Rrezhda

Th. Koroveshi

2.2.5- Certifikatat te lëshuara nga organet te vlerësimit te konformitetit.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik ofertues të disponojë certifikatat e sistemeve të menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë në punë, të lëshuara nga organe të akredituara të vlerësimit të konformitetit, në përputhje me standardet ndërkombëtare ISO.

Këto certifikata përfaqësojnë sisteme të brendshme të menaxhimit të organizatës dhe dëshmojnë kapacitetin real të operatorit ekonomik për të planifikuar, zbatuar dhe kontrolluar proceset e punës në mënyrë të standardizuar, të qëndrueshme dhe të kontrolluar. Duke qenë se objekti i prokurimit konsiston në rikonstruksionin e një stacioni pompimi, i cili përfshin punime civile, mekanike dhe elektrike me ndikim të drejtpërdrejtë në funksionimin dhe sigurinë e sistemit, zbatimi i standardeve të menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe sigurisë në punë është thelbësor për garantimin e rezultateve të kërkuara.

Për këtë arsye, kërkohet që këto certifikata të jenë të vlefshme dhe të lëshuara për operatorin ekonomik ofertues ose për anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë, duke reflektuar kapacitetin real organizativ dhe sistemin e menaxhimit të subjektit që do të zbatojë kontratën.

2.2.6 Mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik ofertues të disponojë mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për realizimin e punimeve objekt prokurimi, duke marrë në konsideratë natyrën dhe kompleksitetin e punimeve që do të kryhen në kuadër të rikonstruksionit të stacionit të pompimit, të cilat kërkojnë disponueshmëri të menjëhershme dhe përdorim të vazhdueshëm të mjeteve dhe pajisjeve të specializuara për punime civile, mekanike dhe elektrike.

Disponimi i këtyre mjeteve dhe pajisjeve nga operatori ekonomik ofertues ose nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë garanton kapacitetin real teknik dhe organizativ për realizimin e kontratës brenda afateve të përcaktuara, si dhe siguron menaxhim efikas të proceseve të punës në stacion . Kjo është thelbësore për garantimin e cilësisë së punimeve, sigurisë në punë dhe vazhdimësisë së aktivitetit gjatë fazës së zbatimit.

Synohet që të sigurohet që operatori ekonomik që do të zbatojë kontratën të ketë në dispozicion kapacitetet teknike të nevojshme për realizimin me sukses të saj.

Per sa me siper nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Së gjashti: sqarojmë se :

Tek Specifikimet teknike, që i bashkangjiten Shtojcës 5 të DT, tek pika 1.5 “Kerkesat per Serverët SCADA”, bashkangjiten specifikimet teknike si vijon:

“ Kërkesa të përgjithshme

- Sistemi SCADA duhet të sigurojë monitorim dhe kontrollin operativ në kohë reale të stacionit të pompimit dhe pjesëve ndihmëse të sistemit, regjistrimin historik të të dhënave dhe alarmeve, të rrisë sigurinë dhe lehtësinë e mirëmbajtjes të sistemit.
- Ndërfajja e sistemit të operimit duhet të jetë e qartë, fleksibël dhe intuitive për të siguruar përdorimin e lehtë dhe efektiv të saj nga operatorët duke përdorur standardet më të mira të industrisë.

R. Rrezhda

Th. Koroveshi

- SCADA duhet të ketë mundësinë të ruaje të dhëna për minimalisht 2 vite.

Detyrat e sistemit SCADA

SCADA duhet të ketë aftësinë të realizojë:

- Komunikimin me të gjitha pajisjet I/O të sistemit
- Monitorimin e situatave të alarmit
- Ndërtimin e raporteve me të dhënat e mbledhura
- Shfaqjen e grafikëve të të dhënave.

Menaxhimi i alarmeve

- Menaxhimi i avancuar i alarmeve është thelbësor për t'u siguruar që personeli i impiantit të mos humbasë ngjarjet kritike. Duhet përdorur një qasje e sofistikuar për menaxhimin e alarmit që shfrytëzon forma, ngjyra dhe numra për të komunikuar shpejt statusin e alarmit.
- Alarmet duhet të jenë të konfigurueshëm në pranimin shkak dhe përgjigje, opsionet e filtrimit dhe renditjes, deklaratat e arsytimit dhe vendosjen në pritje të alarmit. Ky fleksibilitet në menaxhim është i nevojshëm për kontrollin e operacioneve dhe monitorimin.
- Hierarkia e alarmeve duhet të jetë e tillë që alarmet me prioritet më të lartë t'i tërheqin vëmendjen operatorit menjëherë.

Pamjet dhe grafika vizuale

- Duhet të përdoren teknikat si ngjyrosja me shkallë gri dhe animacioni i thjeshtëzuar duhet të reduktojnë kompleksitetin dhe përmirësojnë kohët e reagimit për të gjithë përdoruesit.
- Opsionet intuitive të dizajnit të ndërfaqes, si navigimi i bazuar në menu, për të lejuar zgjedhjen se si të theksoni numrin dhe rrezikshmerinë e alarmeve.
- Hierarkitë e pajisjeve duhet të lidhin komponentet e ndërfaqes që përputhen me rrjedhën aktuale të procesit.

Protokollet

- **Sistemi duhet të ketë ndërlidhje me të gjitha protokollet standarde të industrisë por minimalisht me: OPC UA, BACNET, IEC61850 ose sipas standardit SSH/IEC/ISO ekuivalente të këtij standardi, të lëshuar nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë, MODBUS. “,**

R. Rrezhda

Th. Koroveshi

Së shtati: sqarojmë se :

Tek Specifikimet teknike, që i bashkangjiten Shtojcës 5 të DT, tek specifikimet për kontrollerrat , bashkangjiten specifikimet teknike si vijon:

“ Kërkesa të përgjithshme

- Kontrolleri duhet të jetë modular dhe me mundësi zgjerimi.
- Duhet të jetë me arkitekturë Ethernet që të lehtësojë komunikimin ndërmjet moduleve I/O dhe “rack”-ut si dhe për integrim në sistemin SCADA.
- Kontrolleri duhet të ketë kapacitetin për redundancë për të siguruar vijueshmerinë e sistemit, ku programi dhe konfigurimet I/O pasqyrohen në një kontrollor redundant.
- Kontrolleri dhe modulet duhet të jenë të pajisura me sinjalistikë LED për të sinjalizuar kushtet e operimit dhe gjendjen e sinjaleve individuale.
- Aplikimet specifike I/O: Lidhje seriale, kontrolli i lëvizjes, HART, numerues, stampimi i saktë i kohës
- Tipi i aplikimit të kontrollit duhet të jetë i përshtatshëm për kontroll procesi
- Kanalet e kontrollit me konturet e programueshme
- Portat e intrguara: 1 Porte Ethernet TCP/IP për shërbim, 2 Porta Ethernet TCP/IP për pajisjet e rrjetit, portë USB mini B për lidhje për programim

Kërkesat e kushteve ambientale

Temperatura e ambientit të punës: 0...60 °C

Lartësia e punës: 0...2000 m

Lagështira relative: 5...95 % në 55 °C pa kondensim

Certifikimet dhe Standardet

Certifikimet minimale të produkteve: CE ”

Së teti: sqarojmë se :

Tek Specifikimet teknike, që i bashkangjiten Shtojcës 5 të DT, tek pika 5.3 specifikimet për matës elektromagnetik:

“ Materiali i kërkuar për veshjen e brendshme të matësit elektromagnetik është polipropilen ose zgjidhje ekuivalente të përdorur për industrinë e ujit të pijshëm siç mund të jete PTFE ose gomë e fortë (Hard Rubber). Veshjet PTFE (politetrafluoroetilen) dhe/ose goma e fortë (hard rubber/ebonite) do të jenë të pranueshme. ”

Së nënti: sqarojmë se :

Në dokumentin SPECIFIKIME “**specifikime teknike** të materialeve elektrike, mekanike dhe hidraulike” , efienca për elektromotorët dhe pompat 550 Kw si dhe elektromotorët dhe pompat 305 kW , të ndryshuara janë si vijon:

“ Efienca e elektropomës që nënkupton elektromotor dhe pompë të dyja bashkë si agregat të kenë një rendiment mbi 80%. ”

R. Rrezhda

Th. Koroveshi

Argumentimi:

Në lidhje me rendimentin e elektropomës kërkojmë rendiment mbi 80% për të patur efikasitetin e prodhimit të ujit sa më të lartë dhe me humbje të energjisë dhe konsumim të energjisë të jetë sa më i ulët.

Kërkojmë ky rendiment sepse fuqia e instaluar e elektropompave është 550kW dhe 305kW dhe si pasojë e fuqisë së madhe që zoterojnë këto pompa krijohen shume humbje në elektromotor dhe rendimenti i pompës bie dukshëm. E sqaruar me teknikisht kur në një konsum prej 100kW konsum energjie në elektromotor me rendiment të përbashkët të elektropomës 80% rezulton ky faktor ku 80kW kalojnë për ngritje mekanike prodhim uji dhe 20kW kalon në humbje në elektromotor si nxehtësi, fushë elektromagnetike. Prandaj kërkojmë që rendimenti total i elektropomës të jetë mbi 80% për arsye të prodhimit të ujit me konsum energjie sa më të ulët.

Së dhjetë: sqarojmë se :

Në specifikimet teknike Shtojca 5 e DT, në fund të fjalisë:

“ Fletë garanci me afat minimal 2 vjet për pajisjet/mallrat: transformatorë, invertera, elektropompa, SCADA dhe pajisjet e saj”, janë shtuar fjalët

“të lëshuar nga prodhuesi ...”

Argumentimi:

Përsa i përket kërkesës për: “ Fletë garanci me afat minimal 2 vjet për pajisjet/mallrat: transformatorë, invertera, elektropompa, SCADA dhe pajisjet e saj”, sqarojmë që duhet që OE, që do të jetë fitues dhe do të nënshkruajë dhe zbatojë kontratën me AK, duhet të sigurojë nga prodhuesi fletën e garancisë të pajisjeve dhe vetë OE siguron garanci totale 2 vjecare për të gjithë projektin, punimet përfshirë pajisjet .

Së njëmbëdhjetë: sqarojmë se :

Në dokumentin “Specifikimet.pdf”, “Specifikime teknike të materialeve elektrike, mekanike dhe hidraulike”, në faqet 36 – 38 të dokumentit , specifikimet për pompat 550 kË dhe pompat 305 kË, të ndryshuara janë si vijon:

“... Materiali i kermillit: Bronz ose inoks...”

Së dymbëdhjetë: sqarojmë se :

Në dokumentin “Specifikimet.pdf”, “Specifikime teknike të materialeve elektrike, mekanike dhe hidraulike”, faqet 39-40 të dokumentit ,

për Valvulat me modelin e rekomanduar CLA-VAL 90-01 (ose e ngjashme) me reduktim presioni , **hiqet nga specifikimet teknike termi “galixhant”.**

Së trembëdhjetë: sqarojmë se :

Në dokumentin “Specifikimet.pdf”, faqet 16-19 përcaktimi se “sistemi duhet të ketë 3 server përkatësisht 2 në konfigurim redundant dhe 1 server për databazën e arkivimit si dhe 3 kompjuter operatori. ”, **i ndryshuar është si vijon:**

“..sistemi duhet të ketë 2 server përkatësisht 1 në konfigurim redundant dhe 1 server për databazën e arkivimit si dhe 2 kompjutera operatori. ”

R. Rrezhda

Th. Koroveshi

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

Argumentim i Autoritetit Kontraktor

Në lidhje me përcaktimet në VKM Nr.285/2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publik¹, nën 45 ku kërkohet “Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të kostos, autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdoret, si dhe peshën specifike për secilin kriter, konkretisht, pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e një pasnjëshëm.”, vlerësojmë si më poshtë:

Së pari në DST **Kapitulli 4.4** “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit” Autoriteti Kontraktor gjykoj që të vlerësohet mbi bazën e Ofertës ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto **X**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto ¹ x

Sipas rëndësisë:

Çmimi ☐	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit ☐	pikët 10
Stafi / Organizimi i Kompanisë ☐	pikët 25
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social ☐	pikët 15

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b, 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

R. Rrezhda

Th. Koroveshi

¹Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

$$P_{k1} = V_{mink1} \times P_{maxk1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{maxk1} Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [10 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkrimore dhe grafike) kohën e propozuar (**jo më shumë se 385 ditë ose 55 javë**). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

- a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [5 pikë]
- I Kohën e mobilizimit në kantier (jo me shume se 2 muaj) [2 pike].
- II Grafiku i punimeve te Kontratës. [3 Pike]

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{mink2a} \times P_{maxk2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a} Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink2a} Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{maxk2a} Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2a} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

- b. Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

3. Staf / Organizimi i kompanisë [25 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

R. Rrezhda

Th. Koroveshi

Nën-kriteri:

- a. Kualifikimi I stafit Kyc dhe eksperienca ne fushen specifike [15 pikë]

*Shënim: Vlerësimi i këtij nenkriteri do te realizohet sipas percaktimeve me poshte:

I. Dëshmi qe stafi disponon diplome universitare [5 pike]

II. Dëshmi qe stafi disponon pune te ngjashme me objektin e prokurimit [5pikë]

III. Dëshmi qe stafi disponon experience mbi 1(nje) vit pune [2 pike]

IV. Dëshmi qe stafi disponon eksperience ne natyre/kompleksitet te ngjashme me kontraten e prokurimit. [3 pike]

Per permbushjen e kriterëve te mesiperme duhet te dorezohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion te leshuar nga punedhenes te meparshem ose perfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 10 pikë]

*Shënim: Per permbushjen e kriterit te mesiperme operatori ekonomik duhet te dorezoje organigramen e propozuar te stafit qe do te operoje ne ekzekutimin e kontrates, metodologjise te nderveprimit midis strukturave me njera-tjetren, me mbikeqyresin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh perbejne sistemet e brendshme te kontrollit dhe menaxhimit te cilesise.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit te Ndikimit ne Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-8 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-7 pikë]

R. Rrezhda

Th. Koroveshi